



*Shpallje pune për Asistent të KPT-së*

**Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian  
"Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes  
industriale"**

**Nr. Ref. MK 20 IPA EN 02 22**

**ka nevojë për angazhim të  
Asistentit të gjuhës të Këshilltarit të Përhershëm të Tuining-ut (KPT)**

Tuining-Projekti "Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes industriale" është projekt i përbashkët mes Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Republikës së Greqisë, e përfaqësuar nga Qendra për të Drejtën Ekonomike Ndërkombëtare dhe Evropiane (CIEEL).

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve lidhur me zbatimin efektiv të legjislativës nga fusha e ndotjes industrial në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Projekti ka nevojë të angazhojë një Asistent gjuhe të Këshilltarit të Përhershëm të Tuining-ut (Asistent gjuhe i KPT), detyrat e të cilit përfshijnë mbështetjen e KPT-së gjatë koordinimit dhe menaxhimit të Tuining-Projektit. Projekti ka nisur më 1 Mars 2023 dhe do të zgjasë 20 muaj.

Fillimi i angazhimit (indikative): 1 Prill 2023.

Asistenti i gjuhës i KPT-së do të punësohet me kontratë me orar të plotë pune, ndërsa lokacioni i vendit të punës do jetë në Shkup. Asistenti i gjuhës nuk duhet të jetë në asnjë marrëdhënie kontraktuale me sektorin publik në shtetin përfitues, Republikën e Maqedonisë së Veriut, të paktën 6 muaj para punësimit të tij.

**Detyrat e Asistentit të gjuhës të KPT-së janë:**

- Përkthim dhe interpretim në bazë ditore;
- Përkthimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetet e projektit (dispozitat ligjore, rraportet e misionit, korrespondenca, prezantimet e ekspertëve afatshkurtër - EASH, etj.);
- Interpretim për KPT-në dhe EASH-në në të gjitha takimet, punëtoritë, seminarët, konferencat, etj.;



**Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian**





- Pjesmarrje në vizitat studimore si dhe interpretim për pjesëmarrësit nga institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për KPT-në;
- Ndihmë në punën e përgjithshme të zyrës, organizim të takimeve, ndihmë KPT-së dhe asistentit të KPT-së lidhur me zhvillimin normal të punëve në zyrën e projektit.

### **Kualifikimet e nevojshme të kandidatëve:**

Asistenti i gjuhës i KPT-së do të zgjidhet në përputhje me kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes:

Përvoja dhe aftësitë e nevojshme:

- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur, si dhe të gjuhës maqedonase në të shkruar dhe të folur;
- Njohja e gjuhës shqipe do të ketë përparësi;
- Diplomë universitare;
- Eksperiencë në asistencë gjuhësore, përkthime dhe interpretime;
- Aftësi të shkëlqyera organizative;
- Aftësi të shkëlqyera kompjuterike (MS Word, Excel etj.);
- Përvojë të mëparshme në projekte të financuara nga BE ose projekte të tjera ndërkombëtare, ndërsa përvoja me IPA-Tuning do jetë aset;
- Njohja e terminologjisë së legjislacionit mjedisor paraqet aset.

Kandidatët duhet të dërgojnë biografite të tyre (në format Europas) me letër motivimi në anglisht në adresën elektronike: [eu.twinning.ied@gmail.com](mailto:eu.twinning.ied@gmail.com) me titull „RTA Language Assistant” jo më vonë se në datën 26 Mars 2023. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Dokumentet që duhen bashkëngjitur në versionin e skanuar si pjesë e aplikimit:

- Diploma e arsimit të lartë;
- Certifikatë për njohjen e gjuhës (nëse ka);
- Rekomandime nga punëdhënës/it të mëparshëm (nëse ka).



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

